



NJOFTIM

Diskusim Publik për Strukturën Tarifore

E premte, 28 shkurt 2014, prej 9:00h

Hotel "Sirius"

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të mbajë Seancë Publike për të diskutuar në lidhje me analizën e bërë për strukturën tarifore. Seanca do të mbahet me 28 shkurt 2014, në hotel "Sirius" (Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë), prej orës 9:00.

Me qëllim të përfshirjes së publikut dhe palëve të interesit, dhe në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka hartuar dokumentin "Raport Konsultativ për Strukturën Tarifore", ku janë paraqitur opsionet e mundshme lidhur me ndryshimin e strukturës ekzistuese tarifore. Gjatë hartimit të dokumentit ZRRE-ja ka marrë parasysh kërkesat nga palët e interesuara, të cilat i janë drejtuar ZRRE-së, dhe i ka kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pas një analize të kujdesshme të strukturës ekzistuese tarifore, Bordi i ZRRE ka vendosur që strukturën e tanishme tarifore ta shqyrtojë përmes konsultimit publik.

Dokumenti "Raport Konsultativ për Strukturën Tarifore" është i publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE: www.ero-ks.org. ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komentet e tyre në këtë dokument deri me datë 05.03.2014. Komentet mund të dërgohen në emalin info@ero-ks.org me titull "Komente për strukturën tarifore". Po ashtu për këtë qëllim ZRRE do të organizoj edhe seancën publike me 28 shkurt, ku përveç prezantimit do t'ju përgjigjet pyetjeve të ndryshme dhe do të pranoj komentet e palëve të interesuara.

RENDI I DITËS

9:00-9:10 – Fjala Hyrëse - Z. Enver Halimi, Kryesues i Bordit të ZRRE

9:10-9:20 – Baza ligjore për strukturën tarifore – Znj. Merita Kostari, Anëtare e Bordit të ZRRE

9:20 – 9:40 – Prezantimi i analizës së ZRRE për Strukturën Tarifore - Z. Krenar Bujupi, Anëtar i Bordit

9:40 -10:30 – Pyetje përgjigje

10:30- 11:00 – Pushim i kafes

11:00-12:00 – Komente dhe sugjerime